

Nr. Prot. 24

Tiranë, 12.07.2024

**Lënda:** Kthim përgjigje e shkresës Nr. 2744, datë 08/07/2024

**Drejtuar:** Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorruptionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

**Inderuar Z. Xhafaj,**

Duke ju uruar të jeni mirë, dëshiroj të konfirmoj në emër të Qendrës Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim - (SCiDEV), marrjen e shkresës Nr. 2744, datë 08/07/2024, për bashkëpunim në kuadër të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorruptionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

SCiDEV është një qendër kërkimore që punon në bashkëpunim me partnerë në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Evropian për të kontribuar në demokratizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik. Së pari, ekspertiza jonë kryesore është në promovimin e lirisë së shprehjes, lirisë së medias, sigurinë e gazetarëve, fuqizimi i mediave të pavarura dhe promovimi i edukimit përmes median dhe informacionin. Së dyti, ekspertiza jonë është në transformimin digital dhe inovacionin, me fokus tek të drejtat dhe aftësitetë digitale, siguria kibernetike dhe fuqizimi social dhe ekonomik i vajzave dhe grave përmes rritjes së përfaqësimit në STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë). Së terti, ne lehtësojmë bashkëpunimin ndërmjet botës akademike dhe aktorëve të tjera përmes transferimit të njohive, angazhimit të diasporës, rrjetëzimit, zhvillimit të projekteve dhe promovimit të modelit të Heliksit të Katërfisht. Së katërti, fuqizimi i demokracisë dhe qeverisjes së mirë, nëpërmjet kryerjes së projekteve kërkimore të aplikuara dhe të orientuara drejt politikave, për të fuqizuar praktikat demokratike të institucioneve, dhe për të fuqizuar qytetarët të kërkojnë ndryshim.

SCiDEV është anëtar i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, si dhe anëtar i Platformës së Partneritetit me Shoqërinë Civile për Integrimin Europian për Kriterin Politik. SCiDEV është angazhuar thëllësisht në procesin e konsultimit për Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. SCiDEV do të vazhdoj të forcojë ekspertizën për kërkim dhe advokim dhe do të angazhohet në dialog me palët e interesuar për të kontribuar më tej në proceset demokratike në Shqipëri.

Duke vlerësuar ftesën tuaj për të qenë pjesë e Grupit të Ekspertëve apo Sekretariat Teknik, struktura që do të ngrihen pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, dhe duke u bazuar tek fushat e eksperitzës së SCiDEV dhe rrjetit të ekspertëve të asociuar me ne, dhe rolin dhe angazhimin publik të organizatës sonë në advokim, informim politikash të bazuar në evidencë, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije që SCiDEV shpreh interesin për të ndjekur veprimtarinë e Komisionit përmes pjesëmarrjes



në tryeza diskutimi dhe konsultimi, si dhe dhënie mendimi për produktet konkrete të Komisionit gjatë proceseve konsultuese.

Për të sa më sipër, do të vlerësonim nëse Komisioni do të ndante metodologjinë e angazhimit organizatave të shoqërisë civile që nuk do të janë pjesë e grupeve të punës dhe sekretariatit teknik, planin e punës dhe kalendarin e takimeve me shoqerinë civile dhe grupet e interesit dhe ndërkombëtarët në mënyrë që SCiDEV të planifikojmë përkatësisht angazhimin në këto procese konsultuese. Ne besojmë se qasja e bazuar në transparencë dhe gjithëpërfshirje që në një nisje të veprimtarisë së Komisionit është thelbësore për të thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë.

Gjithashtu, sipas kërkësës suaj, bashkëlidhur kësaj shkresë gjendet një listë me publikime të SCiDEV të cilat ndërlidhen edhe me fushën e veprimit të Komisionit.

Me konsideratë,

**Blerjana BINO**

Drejtore Ekzekutive

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim

**Lista e disa publikimeve të Qendrës Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim - (SCiDEV)**

1. Dokument Politikash: Avancimi i Kërkimit dhe Inovacionit të orientuar nga dhe transferimi i njojurive në Ballkanin Perëndimor, 2023 [<https://scidevcenter.org/2023/10/19/policy-paper-advancing-mobility-driven-research-and-innovation-and-knowledge-transfer-in-western-balkans/>]
2. Zgjerimi i BE-së dhe Ballkani Perëndimor: Sfidat dhe perspektivat aktuale, 2023 [<https://scidevcenter.org/2023/07/10/scidev-papers-in-institute-of-european-studies-conference-proceedings-2/>]
3. Hartëzimi i shkeljeve të të dhënave personale në Shqipëri: Një retrospektivë e shkurtër mbi shkeljet masive në vend, Tiranë, 2022 [<https://scidevcenter.org/2023/02/23/4019/>]
4. Angazhimi i OSHC-ve shqiptare në procesin e anëtarësimit në BE: Sfidat dhe Mundësítë, Tiranë, 2022 [<https://scidevcenter.org/2022/12/16/scidev-presents-the-study-on-the-engagement-of-albanian-csos-in-the-eu-accession-process/>]
5. Ngacija e procesit të integrimit evropian dhe rritja e diskurseve populiste në Shqipëri, Tiranë, 2022 [<https://scidevcenter.org/2022/04/13/the-standstill-of-the-european-integration-process-and-the-surge-of-populist-discourses-in-albania/>]
6. Të dhënë për advokaci: Mbyllja e hendekut të përfaqësimit të STEM në Shqipëri, Tiranë 2022 [<https://scidevcenter.org/2022/11/29/4015/>]